

VENDIM
Nr.1517, datë 19.11.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.495, DATË 1.8.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E PAGAVE DHE TË SHITESAVE MBI PAGË TË
PUNONJËSVE TË PËRFAQËSIVE DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, NË SHTETET E HUAJA”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, të nenit 45 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.495, datë 1.8.2007 të Këshillit të Ministrave bëhen këto ndryshime:
 - a) Lidhja nr.1 “Paga mujore e personelit diplomatik, të përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë, në shtetet e huaja”, e përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 - b) Lidhjet nr.3 “Paga mujore e personelit administrativo-teknik (me kohë të plotë) të përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë në shtetet e huaja”, dhe nr.3/1 “Paga mujore e personelit administrativo-teknik (me kohë të pjesshme) të përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë në shtetet e huaja”, të përmendura në pikat 8 e 9, zëvendësohen me lidhjet me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.
 2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara, për rritjen e pagave, për vitin 2008.
 3. Ngarkohen Ministri i Punëve të Jashtme dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Pozicioni	Paga mujore	
	1	2
	Paga bazë mujore (në euro dhe dollarë USD)	Shtesa për përfaqësim (në%)
Ambasador	1250 euro 1520 dollarë USD	75%
Konsull i Përgjithshëm Ministër Fuqplotë Ministër Këshilltar	940 euro 1140 dollarëUSD	75% 40% 40%
Këshilltar	780 euro 990 dollarë USD	40%
Sekretari parë Konsull	630 780 dollarë USD	40%
Sekretar i dytë Zëvendëskonsull	480 620 dollarë USD	40%
Sekretar i tretë Agjent konsull	430 530 dollarë USD	40%
Atashe	380 480 dollarë USD	40%

Lidhja nr. 3

PAGA MUJORE E PERSONELIT ADMINISTRATIVO-TEKNIK (ME KOHË TË PLOTË), TË PËRFAQËSIVE DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NË SHTETET E HUAJA

Pozicioni	Paga mujore				
	Grupi 1	Grupi 2	Grupi 3	Grupi 4	Grupi 5
Sekretar teknik Financier Specialist	790 euro 890 dollarë USD	750 euro 850 dollarë USD	720 euro 820 dollarë USD	690 euro 790 dollarë USD	640 euro 740 dollarë USD
Shofer	750 euro 850 dollarë USD	710 euro 810 dollarë USD	680 euro 780 dollarë USD	650 euro 750 dollarë USD	600 euro 700 dollarë USD
Kafaz	620 euro 680 dollarë USD	580 euro 640 dollarë USD	550 euro 610 dollarë USD	520 euro 580 dollarë USD	470 euro 530 dollarë USD

PAGA MUJORE E PERSONELIT ADMINISTRATIVO-TEKNIK (ME KOHË TË
PJESSHME) TË PËRFAQËSIVE DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NË
SHTETET E HUAJA

Pozicioni	Paga mujore (me kohë të pjesshme)		
	Minimumi	Maksimumi	
Sekretar teknik	280 euro	420 euro	
Financier	310 dollarë	470 dollarë	
Specialist	USD	USD	
Pastrues	210 euro	280 euro	
	230 dollarë	310 dollarë	
	USD	USD	